



KONFERENCA E TRETË NDËRQEVERTARE, KM RAMA: NEGOCIATAT TONA ME BE-NË TË MBYLLEN MË 2027

Në Bruksel u mbajt sot Konferenca e tretë Ndërqeveritare Shqipëri – BE për hapjen e Grup kapitullit të VI të negociatave "Marrëdhëniet me jashtë", që përfshin kapitujt negocies 30 dhe 31, përkatësisht "Marrëdhëniet e jashtme" dhe "Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes". Delegacioni shqiptar u kryesua nga kryeministri Edi Rama dhe në përbërje të tij ishin Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Igli Hasani, Ministrja e Shtetit dhe Kryenegociatorja Majlinda Dhuka, Ministrja e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Adea Pirdeni, Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Blendi Gonxha, si dhe negociatorët përgjegjës për kapitujt përbërës (30, 31) të grup kapitullit të VI. Kryeministri Rama gjatë konferencës për shtyp me Komisioneri për Fqinjësinë dhe Negociatat për Zgjerim, Marta Kos dhe Péter Szijártó, Ministrin e Punëve të Jashtme të Hungarisë, e cila mban dhe Presidencën e Këshillit të BE, tha se Shqipëria po bën detyrat e shtëpisë dhe se ka objektiv të saj që më 2027 të hapen negociatat me BE-në. Ai tha se brenda dekadës, Shqipëria synon të integrohet në Bashkimin Evropian.




BRUKSEL, NËNSHKRUHET DOKUMENTI I PARTNERITETIT PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN MË SHQIPERISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN

U nënshkrua në Bruksel, Dokumenti i Partneritetit për sigurinë dhe mbrojtjen me Bashkimin Evropian, mes Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Kaja Kallas me ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, dhe ministrin e Mbrotjes, Pirro Vëngu, në praninë e Kryeministrit Edi Rama. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Partneritetit BE-Shqipëri për Sigurinë dhe Mbrotjen është një pasqyrim i qartë i thellimit të bashkëpunimit tonë përballë sfidave gjeopolitike në rritje dhe harmonizimit tonë të vazhdueshëm me politikat e BE-së për çështjet e jashtme dhe mbrojtjen.



MINISTERIALI I NATO-S, MINISTRI HASANI: KOHEZIONI, RËNDËSI KRITIKE PËR SIGURINË NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Igli Hasani mori pjesë në takimin e Ministrave të Punëve të Jashtme të NATO-s, në Bruksel, i pari nën drejtimin e Sekretariatit të ri të Përgjithshëm, Mark Rutte. Ministri bëri me dije se, Shqipëria po investon aktualisht 2.03% të Prodhimit të Brendshëm Bruto në mbrojtje, me fokus modernizimin e Forcave të Armatosura, ndërsa po punohet për arrijen e 3% të PBB, deri në vitin 20230. Në kuadër të miratimit të raportit dyveçar të NATO-s për Ballkanin Perëndimor, ministri Hasani theksoi nevojnë kritike për të forcuar kohezionin e NATO-s, veçanërisht në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit të Ballkanit Perëndimor.



AMBASADA E REPUBLIKËS SË SHQIPERISË NË KIEV DËMTOHET NGA SULMET AJRORE TË FEDERATËS RUSE

Një seri sulmesh ajrore të Federatës Ruse tronditën Kievin, duke shkaktuar dëme të shumta në disa zona në kryeqytetin e Ukrainës. Si pasojë e këtyre sulmeve, u démtuan pjesërisht fasada e jashtme dhe disa hapësira brenda godinës së ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Kiev dhe ambasadave të pesë vendeve të tjera, duke vënë në rrezik jetën e personelit diplomatik. Raportohet vetëm për dëme materiale. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dënon pa asnje mëdyshje këto sulme brutale. Ky akt i pakuptimit është një sulm ndaj themelive të vetë diplomacisë ndërkombëtare. Mbrotja e personelit diplomatik dhe paprekshmëria e misioneve janë parime të panegociueshme që duhet të respektohen dhe të zbatohen plotësisht.



SHQIPËRIA PËRFUNDON DREJTIMIN E PARTNERITETIT TË KARTËS SHBA-ADRIATIKE (A5)

Në cilësinë e kryesisë shqiptare për vitin 2024, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme mirëpriti takimin e Komisionit të Partneritetit të Kartës SHBA-Adriatike (A5), ku të ishin të ftuar Ministrat e vendave të Kartës SHBA-Adriatike (Bosnje dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut), si edhe vendave vëzhguese (Kosova, Serbia dhe Sllovenia, me statusin e të ftuarit). Në ndërhyrjen e tij, Ministri Hasani, theksoi domosdoshmërinë e forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit rajonal në dobi të sigurisë, ndërsa dënoi ashpër sulmin terrorist të 30 nëntorit në Veri të Kosovës duke kërkuar që ky akt kriminal të hetohet dhe autorët të vihen para përgjegjësisë ligjore.



MINISTRI HASANI PRET HOMOLOGUN POLAK: HAPJA E GRUP-KAPITULLIT 6, GUR KILOMETRIK PËR BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani priti në vizitë zyrtare në Tiranë, Ministrin e Punëve të Jashtme të Polonisë, Radosław Sikorski. Vizita u vlerësua si një moment i rëndësishëm për forcimin e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Polonisë. Dy ministrat konfirmuan nivelin shumë të mirë të bashkëpunimit dypalësh dhe rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të tij në fusha me interes të ndërsjellë. Në deklaratën e përbashkët për shtyp, pas takimit dypalësh, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani e cilësoi Konferencën e Tretë Ndërqeveritare mes Shqipërisë dhe BE-së, si hap të rëndësishëm në rrugën drejt anëtarësimit.



MBAHET NË MEPJ TAKIMI VJETOR I KËSHILLIT KOORDINUES TË DIASPORËS

U mbajt në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, takimi vjetor i Këshillit Koordinues të Diasporës. Kryeministri Edi Rama në fjalën e tij u ndal në strategjinë kombëtare të diasporës si dhe përcaktimin e koordinatorëve shtetërorë të diasporës, që ndjekin sektorë dhe fusha të ndryshme. Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani bëri me dije lajmin e mirë për shqiptarët që jetojnë jashtë vendit, veçanërisht për ata që punojnë në organizatat ndërkombëtare, do të vijë së shpejti me ndryshimet e propozuara në ligjin për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë.



SHQIPËRIA MERR PJESE NË SEANCAT DËGJIMORE TË GJND MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE

Një delegacion i MEPJ mori pjesë në seancën dëgimore të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, në kuadrin e procedurave këshillimore për përcaktimin e detyrimeve të shteteve ndaj ndryshimeve klimatike. Shqipëria theksoi nevojnë për përballimin proporcional të efekteve negative të ndryshimeve klimatike nga vendet e zhvilluara dhe ato me të ardhura mesatare. Ai i kërkoi Gjykatës që të njohe përgjegjësinë e shteteve të zhvilluara që me aktivitetet e tyre shkaktojnë ndotje të theksuar të mjedisit dhe që të asistuar shtetet e tjera në përballimin e efekteve negative të ndryshimeve klimatike.



BILANCI 2025 DHE PRITSHMËRITË 2025, MINISTRI HASANI BASHKËBISEDIM ME GAZETARËT

Në mbyllje të një viti të suksesshëm për politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani pati një bashkëbisedim me gazetarët, ku mes të tjerash theksoi se 2025 pritet të jetë një vit sfidash dhe mundësish, duke shtuar se angazhimi do të jetë maksimal për të mbrojtur sa më mirë interesat kombëtare. Ambicia e Shqipërisë për të hapur të gjithë grupkapitujt e anëtarësimit me Bashkimin Europian brenda 2025, për ministrin Hasani, jo vetëm është e realizueshme por nuk do të ndikohet as nga çështjet e pazgjidhura dypalëshe. Gjithashtu, ministri Hasani tha se në krye të prioriteteve të diplomacisë shqiptare për 2025 do të jetë edhe Kosova, me qëllim ruajtjen e stabilitetit dhe integritetit të saj, duke qenë avokatja kryesore për anëtarësimin e saj euroatlantik. Në këtë kuadër, ministri i Jashtëm tha se Shqipëria tashmë ka nisur edhe përgatitjet për pritjen e samitit të NATO-s në 2027.

